



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR

27061
Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 04.08.2025

URDHËR
Nr. 27061, datë 04.08.2025

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ULJEN E NUMRIT TË ÇËSHTJEVE TË
PRAPAMBETURA 2025 – 2027 TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të nenit 148/dh, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 15, pika 2, shkronja “e” të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar, nenit 42 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, 2025-2027 të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen Prokurorët, Kabineti i Drejtuesit, Kancelari, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, dhe stafi administrativ përkatës pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Kancelari, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin Dumani

